



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 136

Tiranë – E hënë, 24 shtator 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 62/2018 datë 20.9.2018	Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë–Elbasan.....
	9281
Dekret i Presidentit nr. 10882, datë 20.9.2018	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit.....
	9285
Ligj nr. 63/2018 datë 20.9.2018	Për Eurobondin që do të emetohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe blerjen mbrapsht (<i>Buyback</i>) të një pjese të Eurobondit ekzistues miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen.....
	9285
Dekret i Presidentit nr. 10883, datë 20.9.2018	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit.....
	9286



LIGJ
Nr. 62/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR
ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (OFID),
PËR PROJEKTIN E PUNIMEVE
PËR RIPARIME EMERGJENTE
TË AUTOSTRADËS
TIRANË–ELBASAN**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, 84, pika 4, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë –Elbasan, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 20.9.2018

NR. I HUAS 13406P

**PROJEKTI I PUNIMEVE PËR
RIPARIME EMERGJENTE TË
AUTOSTRADËS TIRANË–ELBASAN**

MARRËVESHJE HUAJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR
ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (OFID)

Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Fondit të OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar (“OFID”).

Duke pasur parasysh se Huamarrësi ka kërkuar një hua nga OFID-i për financimin e pjesshëm të Projektit të përshkruar në skedulin 1;

Dhe duke pasur parasysh se OFID-i ka aprovuar një hua për Huamarrësin në shumën e gjashtëmbëdhjetë milionë dollarëve (\$ 16,000,000) sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara më poshtë;

Si rrjedhojë, palët e kësaj Marrëveshjeje Huaje (Marrëveshja) në këtë mënyrë bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme; përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme bashkëlidhur këtij dokumenti janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përveç kushteve të përcaktuara në hyrje, kushtet dhe shprehjet e mëposhtme mbartin kuptimet e mëposhtme ose kur zëvendësojnë kushtet dhe shprehjet në kushtet e përgjithshme, mbartin kuptimet e mëposhtme specifike:

a) **“Përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit”** nënkupton Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë së Huamarrësit;

b) **“Datë e Mbylljes”** nënkupton datën 31 dhjetor 2019;

c) **“Dollar dhe shenja \$”** nënkuptojnë dhe i referohen monedhës së ligjshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës;

d) **“Datë e Fillimit të Shpenzimeve të Pranueshme”** nënkupton datën 22 qershor 2018;

e) **“Agjenci Zbatuese”** nënkupton Autoritetin Rrugor Shqiptar;

f) **“Kushtet e Përgjithshme”** nënkuptojnë kushtet e përgjithshme të OFID-it, të zbatueshme për marrëveshjet e huas për sektorin publik, mars 2007;

g) **“Periudhë pa pagesë principali”** nënkupton periudhën që fillon në datën e Marrëveshjes dhe që përfundon 5 (pesë) vjet pas asaj date.

Neni 2

Huaja

2.01 OFID-i bie dakord t'i japë hua Huamarrësit dhe Huamarrësi bie dakord të marrë hua nga OFID-i, Huan në shumën e gjashtëmbëdhjetë milionë dollarëve (\$ 16,000,000) sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2.02 Huamarrësi shlyen interesin në normën e dy dhe tri të katërtave të njëpërqindshit (2.75%) në



vit të shumës së principalit të Huas së tërhequr dhe të papaguar.

2.03 Huamarrësi paguan një Detyrim Shërbimi vjetor në normën e njëpërqindshit (1%) të shumës së principalit të Huas së tërhequr dhe të papaguar.

2.04 Interesi dhe Detyrimet e Shërbimit paguhen çdo gjashtë muaj, më 15 shkurt dhe 15 gusht të çdo viti në llogarinë e OFID-it.

2.05 Menjëherë pas përfundimit të periudhës pa pagesë principali, Huamarrësi shlyen principalin e Huas në dollarë ose në çdo valutë tjetër lirisht të këmbyeshme dhe të pranueshme për menaxhimin e OFID-it, në një shumë të barasvlershme me shumën në dollarë për t'u paguar sipas kursit ekzistues të këmbimit të tregut në kohën dhe vendin e shlyerjes. Shlyerja do të kryhet në 30 (tridhjetë) këste gjashtëmujore në shumat dhe datat ku të gjitha specifikohen në skedulin 3 (AMORTIZIMI).

Neni 3

Hyrja në fuqi

3.01 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt në përputhje me seksionin 3.02, pas marrjes nga OFID-i:

a) të provave të mjaftueshme së ekzekutimit dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit të jetë e autorizuar dhe miratuar sipas rregullave, në përputhje me kërkesat kushtetuese të Huamarrësit;

b) të një vërtetimi të lëshuar nga ministri i Drejtësisë ose prokurori i Përgjithshëm apo çdo autoritet tjetër kompetent ligjor i Huamarrësit që konfirmon se kjo Marrëveshje është autorizuar dhe miratuar sipas rregullave nga ana e Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe detyrues për Huamarrësin në përputhje me kushtet e saj.

3.02 Menjëherë, pasi kushtet e përcaktuara në seksionin 3.01 të jenë përmbushur në mënyrë të kënaqshme, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe efekt të plotë në Datën e Hyrjes në fuqi.

3.03 Nëse kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas Datës së Marrëveshjes, Marrëveshja dhe gjithë detyrimet e palëve përfundojnë, me përjashtim të rastit kur menaxhimi i OFID-it, pasi të ketë marrë në konsideratë shkaqet e vonesës, përcakton një datë më të vonshme për qëllime të këtij seksioni.

Neni 4

Adresat

4.01 Adresat e palëve specifikohen më poshtë:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
1001, Tiranë
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Faks: (+355-4) 229200

Për OFID-in:

The OPEC Fund for International Development

Parkring 8
A-1010 Vienna
AUSTRIA
Facsimile: (+43-1) 513 92 38

NË DËSHMI sa më sipër palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë realizuar nënshkrimin dhe dorëzimin e kësaj Marrëveshjeje në Vienë në dy kopje, në gjuhën angleze, secila konsiderohet origjinale dhe të dyja me ndikimin e njëjtë dhe të vetëm sipas datës dhe vitit të shkruar më sipër.

PËR HUAMARRËSIN:

Nënshkrimi:

Emri: SH.T. Arben Ahmetaj

Pozicioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Data: shtator 2018

PËR FONDIN OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (OFID):

Nënshkrimi:

Emri: Z. Suleiman J. Al-Herbish

Pozicioni: Drejtori i Përgjithshëm

Data: 10 shtator 2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI I PUNIMEVE PËR RIPARIME
EMERGJENTE TË AUTOSTRADËS
TIRANË–ELBASAN

SKEDULI 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Projekti ka si qëllim rikuperimin e aksidenteve/ rreziqeve gjeologjike përgjatë autostradës Tiranë–Elbasan (segmenti 1), duke përmirësuar qëndrueshmërinë e saj të përgjithshme operacionale dhe duke eliminuar rreziqet e sigurisë



dhe mbylljet e rrugës për shkak të rrëshqitjeve të tokës. Objektivi i projektit do të arrihet nëpërmjet zbatimit të komponentëve të mëposhtëm:

1. Punime civile për riparime: ky komponent përfshin riprofilizimin e sigurisë së skarpateve (punime për mbrojtjen e rrëshqitjes së dheut); stabilizimin e skarpateve që përfshin shufrat e ankorimit dhe shtrimin e tubave të kullimit në zonat e paqëndrueshme; punime hidraulike voluminoze, duke përfshirë ndërtimin e kantierëve dhe kanaleve të kullimit dhe devijimit të lumenjve/rrymave, punë riparuese në strukturat e dëmtuara ekzistuese dhe ndërtimin e strukturës mbrojtëse që përfshin mure me pilota dhe mbushjen fundore.

Për më tepër, financimi përfshin përmirësime në dizajnin origjinal të projektit (8 kilometra rrugë hyrëse dhe 1 nënkalim, barriera mbrojtëse çeliku dhe sinjalistikën) dhe rehabilitimin e shërbimeve publike (zyra të reja për zjarrfikësit e zonave pyjore).

2. Shërbimet e mbikëqyrjes dhe konsulencës: ky komponent përfshin financimin për studimet teknike të kryera, gjithashtu, edhe shërbimet e konsulencës mbikëqyrëse.

3. Menaxhimi i Projekti: ky komponent përfshin financimin për shpenzimet e Njësise së Menaxhimit të Projektit (PMU).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI PËR PUNIMET RIPARUESE EMERGJENTE
NË AUTOSTRADËN TIRANË–ELBASAN

SKEDULI 2
ALOKIMI I HUAS

1. Përveç kur bihet dakord ndryshe ndërmjet Huamarrësit dhe menaxhimit të OFID-it, tabela e mëposhtme përcakton komponentët, të cilët do të financohen nga të ardhurat e Huas, alokimin e shumave të huas ndaj çdo komponenti dhe përqindjen e shpenzimeve totale për zërat që do të financohen për sa i përket secilit komponent:

Komponenti	Shuma e caktuar e Huas shprehur në dollarë	Përqindja e Shpenzimeve totale për t'u financuar
1. Punime civile për riparime	14,860,000	26.92
2. Shërbimet e mbikëqyrjes dhe konsulencës	1,100,000	42.47
3. Menaxhim projekti	40,000	11.43
Totali	16,000,000	

2. Pavarësisht nga alokimi i shumës së Kredisë apo përqindja e disbursimit të përcaktuar në tabelën më sipër në paragrafin 1, nëse menaxhimi i OFID-it ka vlerësuar në mënyrë të arsyeshme se shuma e Huas së alokuar në atë kohë për çdo komponent, është e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e rënë dakord për të gjitha shpenzimet e komponentit në fjalë, menaxhimi i OFID-it, duke njoftuar Huamarrësin: i) do të rialokojë komponentin në fjalë, në masën e kërkuar për të siguruar mungesën e parashikuar, shumën e Huas, të cilat më pas i alokohet një komponenti tjetër dhe të cilat, në opinionin e menaxhimit të OFID-it nuk janë të nevojshme për t'u përballur me shpenzime të tjera; ii) nëse rialokimi nuk përmbush plotësisht mungesën e parashikuar, të reduktojë përqindjen e disbursimit, të zbatueshme për shpenzime të tilla, me qëllim që tërheqjet e mëtejshme, në lidhje me komponentin në fjalë, të mund të vazhdojnë derisa të gjitha shpenzimet e parashikuara të jenë realizuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI I NDËRTIMIT TË RRUGËS TIRANË–ELBASAN

SKEDULI 3
AMORTIZIMI

Nr.	Data e shlyerjes	Shuma për t'u paguar (shprehur në dollarë)
1	Gusht 15, 2023	533,330
2	Shkurt 15, 2024	533,330
3	Gusht 15, 2024	533,330
4	Shkurt 15, 2025	533,330
5	Gusht 15, 2025	533,330
6	Shkurt 15, 2026	533,330
7	Gusht 15, 2026	533,330
8	Shkurt 15, 2027	533,330
9	Gusht 15, 2027	533,330
10	Shkurt 15, 2028	533,330
11	Gusht 15, 2028	533,330
12	Shkurt 15, 2029	533,330
13	Gusht 15, 2029	533,330
14	Shkurt 15, 2030	533,330
15	Gusht 15, 2030	533,330
16	Shkurt 15, 2031	533,330
17	Gusht 15, 2031	533,330
18	Shkurt 15, 2032	533,330
19	Gusht 15, 2032	533,330
20	Shkurt 15, 2033	533,330
21	Gusht 15, 2033	533,330
22	Shkurt 15, 2034	533,330
23	Gusht 15, 2034	533,330
24	Shkurt 15, 2035	533,330
25	Gusht 15, 2035	533,330
26	Shkurt 15, 2036	533,330
27	Gusht 15, 2036	533,330
28	Shkurt 15, 2037	533,330
29	Gusht 15, 2037	533,330
30	Shkurt 15, 2038	533,430
Totali		16,000,000



DEKRET

Nr. 10882, datë 20.9.2018

**PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E
PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI
MENJËHERË TË LIGJIT**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 62/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe fondit OPEC për Zhvillimin Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë–Elbasan”.

Neni 2

Dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 62/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe fondit OPEC për Zhvillimin Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë–Elbasan”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ

Nr. 63/2018

**PËR EUROBONDIN QË DO TË
EMETOHET NGA MINISTRI I
FINANCIVE DHE EKONOMISË DHE
BLERJEN MBRAPSHT (BUYBACK) TË
NJË PJESE TË EUROBONDIT
EKZISTUES, MIRATIMIN E
PËRJASHTIMEVE NGA TATIMET E
TAKSAT DHE TË PARASHIKIMEVE PËR
HEQJEN DORË NGA IMUNITETI NË
MARRËVESHJET QË DO TË LIDHEN**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në marrëveshjet, që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë për emetimin e instrumentit “Eurobond” dhe blerjen mbrapsht (*buyback*) të një pjese të Eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020, në përputhje me ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe thelbësisht sipas kushteve të përcaktuara në tekstin e tyre, që i bashkëlidhen këtij ligji, të lejohen parashikimet për heqjen dorë nga imuniteti.

Neni 2

Mbajtësit e titujve të Eurobondit, menaxherët bashkëdrejtues dhe menaxheri për blerjen mbrapsht të një pjese të Eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020, sipas përcaktimeve në marrëveshjet bashkëlidhur, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe çdo tatim apo taksë tjetër në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht nga të gjitha transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me emetimin, mbajtjen, ruajtjen e tregtimin e Eurobondeve dhe me blerjen mbrapsht të një pjese të Eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 20.9.2018

**DEKRET****Nr. 10883, datë 20.9.2018****PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E
PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI
MENJËHERË TË LIGJIT**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4, dhe
nenit 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:**Neni 1**

Shpalljen e ligjit nr. 63/2018 “Për
Eurobondin që do të emetohet nga ministri i
Financave dhe Ekonomisë dhe blerjen mbrapsht
(*Buyback*) të një pjese të Eurobondit ekzistues,
miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat
dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga
imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen”.

Neni 2

Dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi
menjëherë të ligjit nr. 63/2018 “Për Eurobondin
që do të emetohet nga ministri i Financave dhe
Ekonomisë dhe blerjen mbrapsht (*Buyback*) të një
pjese të Eurobondit ekzistues, miratimin e
përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të
parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në
marrëveshjet që do të lidhen”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë